



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 35

Prishtinë, më 21.11.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Liburn Aliu, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi.

Munguan : Daut Haradinaj, Nait Hasani, Rasim Demiri.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MB (Shaban Dreshaj), bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE, NDI-Elton Tota), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Liburn Aliu**, nënkryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 18.11.2011,**
3. **Takimi me zyrtarët e AAK (asociacionit të arkitektëve të Kosovës)**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.11.2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni do të miratoi Procesverbalet e dy mbledhjeve të kaluara dt. 18 dhe 21 të këtij muaji në mbledhjen e radhës.

3. Takimi me përfaqësuesit e AAK (asociacioni i arkitektëve të Kosovës)

Kryesuesi Liburn Aliu përshëndeti dhe falënderoi të ftuarit nga asociacioni i arkitektëve z. Valdet Osmani, zj. Flora Bajraktari dhe z. Uran Kyqyku me të cilët komisioni në të ardhmen do

të duhej të bashkëpunonte, sidomos sa i përket projektligjit për ndërtimin, i cili është paraparë të vjen në Kuvend së shpejti.

Valdet Osmani falënderoj për interesimin institucional për të konsultuar një organizatë profesionale të lëmisë së ndërtimit si partner kryesor i UNESCO-së. AAK shprehë interesimin që të ndihmoj dhe të kontribuoj në rregullimin e bazës ligjore në lëminë e ndërtimit. Lëmitë për të cilat sugjerohet bashkëpunimi janë : Ligji i ndërtimit, planifikim hapësinor, trashëgimi kulturore, prokurim dhe produkte industriale. Zhvillimi i hovshëm me ndërtime të cilin jemi duke përjetuar, përfshin një siguri jo të mjaftueshme ngase çdo investim publik apo privat duhet të plotësoi kushtet teknike, funksionale, efikasitetin energjetike apo stabilitetin statik. Disa pyetje duhet të na preokupojnë p.sh. si këto objekte do të mund të rezistojnë një goditje sizmike apo një nevojë të kohës në kohën e ndryshimeve klimatike. Jashtëzakonisht (**Uran Kyqyku**) e rëndësishme është trashëgimia jonë kulturore materiale e cila përvetësohet nga moskujdesja apo mos puna jonë në ruajtjen e saj. Fusha e projektimit pas luftës është një lëmi e veçantë e cila nuk është e rregulluar në bazë të praktikave të dëshirueshme me BE, ngase projektuesit nuk i nënshtrohen provimeve profesionale duke vepruar pa licencë përkatëse dhe duke mos pas kriter ligjor profesional, me këtë edhe përgjegjësi profesionale. Shumë projekte të sotme (privat ose publik) nuk plotësojnë kriteret teknike, ndaj ato ngritin koston e zbatimit apo mirëmbajtjes së tyre që ndikon në buxhetin tonë. Në këtë drejtim ligji i prokurimit nuk ka rregulluar si duhet institucionin e konkurrencës reale dhe delegimit të duhur të përgjegjësisë profesionale. Objektet kapitale (pjesë e historisë sonë) në Kosovë nuk janë subjekt i konkurseve por trajtohen me oferta tenderuese, çka paraqet një absurd. Ligji i cekur i prokurimit nuk rregullon mirë kërkesën, ngase këto investime duhet të udhëhiqen nga inxhinierët me përvojë, e jo praktikantë fillestarë.

Në draftin e dytë të ligjit për ndërtimin, vazhdoi z. Valdet, Qeveria nuk ka ftuar këtë asociacion, sikurse edhe në draftin për trajtime të ndërtimeve ilegale. AAK nuk bënë dallime në qeverisje, por dëshiron të kontribuoj pa pagesë, ndaj anashkalimi është i pakuptueshëm. AAK-së i interesojnë përgjigjet në shumë pyetje p.sh. pse është bërë anulimi i procesit të licencimit nga MTI, pse nuk zbatohet ligji për planifikim hapësinor etj.

Në vazhdim anëtarët e komisionit shtruan disa pyetje (**Afërdita Berisha, Sevdije Lama, Salih Morina**) rreth projekteve, planeve rregullative, rrënimëve-rregullimeve, projektuesve (që kanë punuar ilegalisht sipas AAK dhe kanë keqpërdor UP-në), anëtarësinë e AAK (sipas AAK sot në Kosovë janë afër 600 arkitekt profesional), bashkëpunimi me këshillin për planifikim hapësinor (të cilët janë joligjor sipas AAK ngase ka konflikt-nuk janë ekspert profesional), fotografimet ajrore (të cilat duhet të mirën parasysh për planifikim hapësinor), objektet pa leje (të tilla ka shumë më tepër se 6000 vetëm në Prishtinë sipas AAK, bile afro 300.000 shtëpia), autostradës, a ka ndonjë organizatë tjetër të tillë përveç AAK (përgjigja ishte se këta janë me ligj ngase shumë shoqata nuk funksionojnë sipas kuvendeve themeluese), licencimi i arkitektëve (licencimet aktuale duhet të hiqen sipas AAK ngase arkitektët profesional ekzistues më mirë do të realizonin përgjegjësinë e tyre) etj. **Etem Arifi** falënderoi dhe përgëzoi për punën e mëtejme të këtij asociacioni ngase komisioni do të duhet të bashkëpunoj me këtë asociacion duke marr parasysh ngulfatjen e Kosovës nga ndërtimet e ndryshme.

4. Të ndryshme

1. Liburn Aliu në këtë pikë, sipas marrëveshjes nga mbledhja e kaluar, shtroj në shqyrtim projektligjin për shërbime këshillimore në bujqësi dhe zhvillim rural.

Salih Morina kryesues i GP tha se në marrëveshje me kryetarin e komisionit, i cili është njëherit edhe anëtar i GP, është pajtuar që ky projektligj të procedohet sa më shpejt ngase është i rëndësishëm sipas raportit të progresit, ndërkaq në anën tjetër nuk ka nevojë të përmirësohet në thelb, përveç në dy tri raste. **Shaban Dreshaj** zyrtar i ministrisë së bujqësisë vërtetoi synimin e z. Morina duke pohuar se Kosova ka shumë nevojë për këtë ligj për shkak se fermeri jonë ka shumë pak informata për investime bujqësore. Sipas këtij ligji secili komunë në kuadër të drejtoratit për bujqësi do të ketë një zyre me këshilltarët profesional të cilët do të janë shtyllë për trajtime të interesave të agrikulturës për atë rajon (Neni 10-**Salih Morina** sugjeroi që në këtë nen

të përmirësohet pika 2.1 me dy këshilltar e jo ashtu si është me tre). **Liburn Aliu** u interesua për involvimin e këshilltarëve privat, për të cilët z. Dreshaj tha se fshatari ynë nuk ka standard për ta paguar, për këtë shkak edhe u hartua ky ligj ngase duhet të kemi këshilltar të licencuar dhe të unifikuar në dy nivele, qendror dhe komunal. Sot kemi shumë këshilltar privat dhe OJQ të ndryshme, por nuk janë të mbikëqyrur nga askush, përfundoi. **Elton Tota (NDI)** reagoi te neni 26 ku duhet të saktësohet institucioni e jo të shkruhet “relevante”.

Komisioni u pajtua që në mbledhjen e radhës ky projektligj të shqyrtohet përfundimisht sipas vërejtjeve të cekura më lartë.

2. Liburn Aliu gjithashtu në këtë pikë sugjeroi të plotësohet mbledhja e dt. 18.11.2011 sa i përket interesimit të anëtarëve të komisionit për buxhetin e vitit 2012, si vijon :

Për MMPH

Në bazë të përfundimeve nga mbledhja e Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor e dates 18.11.2011, ku mori pjesë edhe Ministri i MMPH-së Z. Dardan Gashi, do të donim të na dërgonit informacionet e detajuara që kanë të bëjnë me shpenzimet nga buxheti i vitit 2011, si dhe sygjërimet tuaja për amandamentimin e projektligjit për buxhetin 2012 dhe për shtimin e buxhetit për ministrinë tuaj për projektet e caktuara.

Kërkojmë të na dërgoni një raport të shpenzimeve sipas diskutimeve në mbledhjen e mbajtur më 18.11.2011, për çështjet:

- Raport të shpenzimeve më të detajuar për projektet kapitale në të cilat ka pas progres, si dhe raport për nivelin e realizimit të këtyre projekteve, bazuar në inspektimet e bëra në teren (për vitin 2011). (pyetje nga **Liburn Aliu**)
- Raport në lidhje me projektet kapitale të Ministrisë tuaj, për të cilat në raportin nëntëmujor i shpenzimeve nga Ministria e Financave, figuron shifra 0 euro, arsyetimin për ngecjen e këtyre projekteve dhe fatin e mjeteve të ndara me buxhet të vitit 2011. (pyetje nga **Liburn Aliu**)
- Numri i të punësuarve në Ministrinë tuaj, si dhe numri i të punësuarve sipas Kontratës në vepër, si dhe mënyrën e pagesës së tyre dhe nga cila kategori e pagesave realizohet. (pyetje nga **Sali Morina**)

Per MBPZHR

Në bazë të përfundimeve nga mbledhja e Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor e dates 18.11.2011, ku mori pjesë edhe Ministri i MBPZHR-së Z. Blerand Stavileci, do të donim të na dërgonit informacionet e detajuara që kanë të bëjnë me shpenzimet nga buxheti i vitit 2011, si dhe sygjërimet tuaja për amandamentimin e projektligjit për buxhetin 2012 dhe për shtimin e buxhetit për ministrinë tuaj për projektet e caktuara.

Kërkojmë të na dërgoni një raport të shpenzimeve sipas diskutimeve në mbledhjen e mbajtur më 18.11.2011, për çështjet:

- Raport të shpenzimeve më të detajuar për projektet kapitale në të cilat ka pas progres, si dhe raport për nivelin e realizimit të këtyre projekteve, bazuar në inspektimet e bëra në teren (për vitin 2011), pyetje nga **Liburn Aliu**,
- Raport në lidhje me projektet kapitale të Ministrisë tuaj, për të cilat në raportin nëntëmujor i shpenzimeve nga Ministria e Financave, figuron shifra 0 euro, arsyetimin për ngecjen e këtyre projekteve dhe fatin e mjeteve të ndara me buxhet të vitit 2011. (Në mbledhjen e Komisionit, ministri i Bujqësisë z. Blerand Stavileci ka deklaruar se mjetet nga dy projekte kapitale janë shpenzuar për pagesat direkte), pyetje nga **Liburn Aliu**,
- Raport për mosfigurimin në raportin nëntë-mujor të shpenzimeve të Projektit –Krijimi i Katastrit të vreshtarisë dhe industrisë së verës në Kosovë, përderisa i njëjti figuron te Investimet Kapitale në Buxhetin e Republikës së Kosovës 2011.
- Numri i të punësuarve në Ministrinë tuaj, si dhe numri i të punësuarve sipas Kontratës në vepër, si dhe mënyrën e pagesës së tyre dhe nga cila kategori e pagesave realizohet, pyetje nga **Sali Morina**.

Këto pyetje do ti dërgohen dy ministrive pasi që paraprakisht të shqyrtohen dhe plotësohen eventualisht nga anëtarët e komisionit deri në mbledhjen e radhës.

Mbledhja e radhës u caktua për datën 29 nëntor kur do të shqyrtohet projektligji për Shërbime Këshillimore, sugjerimi i komisionit për projektligjin e Bujqësisë organike, rekomandimi i komisionit për komunitete dhe të ndryshme, mbledhja e sotme përfundoi në orën 12,50.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Nënkryetari i Komisionit,

Liburn Aliu